

SISTEMI I GRANTEVE I BAZUAR NË PERFORMANCË (SGBP)

UDHËZUES PËR KOMUNAT



**Sistemi i Granteve i Bazuar
në Performancë (SGBP)
Udhëzues për komunat**

Botimi i 3-të

Gusht, 2016

Falënderimet

Ku udhëzues është hartuar nga projekti për “Decentralizim dhe Përkrahje Komunave”- (DEMOS).

Tabela e Përmbajtjes

Fjalori i termeve	7
1. Hyrje.....	9
2. Sistemi i Granteve i Bazuar në Performancë	10
2.1. Si funksionon?.....	10
2.2. Objektivat prapa SGBP-së	10
3. Metodologjia e vlerësimit	11
3.1. Treguesit e performancës komunale	11
3.2. Burimet e të dhënave	13
3.3. Peshimi dhe notimi i treguesve.....	13
4. Mekanizmi i ankesës.....	15
5. Kalibrimi dhe përshtatja e granteve	17
5.1. Llojet e grantit dhe modalitetet.....	19
5.1.1. Performuesit më të mirë.....	20
5.1.2. Përmirësuesit më të mirë	21
6. Administrimi i granteve.....	22
7. Masat kundër korrupsionit për komunat partnere të DEMOS-it	24
Shtojca 1: Ndarja e granteve sipas komunave bazuar në rezultate.....	26

Lista e tabelave

Tabela 1: Treguesit dhe fushat e punës	12
Tabela 2: Burimet e të dhënave	13
Tabela 3: Sistemi i peshimit dhe notimit të treguesve	14
Tabela 4: Përmbledhje e progresionit dhe kalibrimit të grantit.....	18
Tabela 5: Llojet dhe modalitetet e granteve	19
Tabela 6: Procedurat administrative të grantit	23

Lista e shkurtesave

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
DEMOS	Decentralizim dhe Përkrahje Komunave
AP	Auditori i përgjithshëm
HSI-K	HELVETAS Swiss Intercooperation - Kosovë
KM	Kushtet Minimale
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
ZKTP	Zyra Komunale e Tatimit në Pronë
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
THV	Të hyrat vetanake
SGBP	Sistemi i Granteve të Bazuara në Performancë
KP	Kriteri i performancës
SMP	Sistemi për menaxhimin e performancës
DTP	Departamenti i tatimit në pronë
BZZH	Bashkëpunimi Zviceran për Zhvillim
AT	Asistenca Teknike

Sistemi i Granteve i Bazuar në Performancë “SGBP”¹: është sistem për dhënien e ndihmës financiare komunave në bazë të performancës së tyre. SGBP-ja e DEMOS-it është e strukturuar që të kushtëzojë qasjen e komunave partnere në grante me performancën e tyre. Performanca e tyre matet në 1.) menaxhimin financiar; 2.) ofrimin e shërbimeve komunale për hapësirat publike, trafikun komunal dhe menaxhimin e mbeturinave; dhe 3.) demokracinë lokale. Performanca komunale ndërlidhet drejtpërsëdrejti me shumën e granteve dhe komunat duhet të tregojnë se janë në përputhje me Kushtet Minimale (KM-të).

Kushtet Minimale “KM-të”: masin kapacitetet e një komune partnere për të kryer disa nga funksionet themelore të saj. Ato përmbushen ose nuk përmbushen. Komunat partnere të cilat nuk mund të demonstrojnë përmbushjen e KM-ve nuk do të kenë qasje në grante. Komunat partnere kualifikohen për të marrë grantet e tyre vetëm atëherë kur përmbushin KM-të.

Financimi i projekteve në fushat e përzgjedhura: komunat partnere dorëzojnë projekt-propozimet për financim në një apo më shumë nga fushat e mëposhtme: hapësira publike, mobilitet, mbeturina, menaxhim financiar dhe demokraci lokale. Për më tepër, në fushat e lartpërmendura komunat mund të marrin asistencë teknike (AT) të para-caktuar dhe sipas kërkesës.

Mbështetja e rezervuar buxhetore për sektorë: u jepet komunave partnere me rezultatin 4.5 (nga 6) apo më të lartë. Komunat të cilat e marrin këtë formë të mbështetjes buxhetore do të kenë më shumë fleksibilitet në shpenzimin e këtij buxheti; nuk kërkohet bashkë-financim dhe nuk ka nevojë për dorëzimin e projekt-propozimeve.

1 Nga “Sistemet e granteve të bazuara në performancë”, Koncepti dhe përvoja ndërkombëtare, UNCDF, faqe iii-iv’

1. HYRJE

Projekti për Decentralizim dhe Përkrahje Komunave (DEMOS) është i financuar nga SDC-ja, i cili zbatohet nga HELVETAS Swiss Intercooperation (HSI). DEMOS-i punon me 17 komuna partnere (shih hartën më poshtë) të cilat janë të grupuara në tri rajone të ndryshme: në Kosovën perëndimore, qendrore dhe lindore, ku jeton përafërsisht 40% e popullsisë së Kosovës (përafërsisht 700,000 qytetarë). DEMOS-i gjithashtu punon me institucionet përkatëse të nivelit qendror.




Figura 1: Harta e komunave partnere

DEMOS-i synon të përmirësojë qeverisjen dhe ofrimin e shërbimeve në hapësira publike, mobilitet, mbeturina, menaxhim financiar dhe demokraci lokale. Mekanizmat primar për arritjen e kësaj janë nëpërmjet Sistemit të Granteve të Bazuar në Performancë dhe asistencës teknike.

2. SISTEMI I GRANTEVE I BAZUAR NË PERFORMANCË

SGBP-ja është mjet i zhvilluar për t'iu ndarë komunave grante në bazë të performancës së tyre në fushat përkatëse të përzgjedhura. Ky sistem është i përqendruar në nxitjen e komunave që të përmirësojnë punën e tyre. Veçoria inovative prapa qasjes së SGBP është krijimi i ndërlidhjes në mes të granteve të cilat një komunë partnere i pranon, me performancën e saj: performancës së mirë në fushat e përzgjedhura i ndahen grante më të mëdha.

2.1. Si funksionon?

SGBP-ja përfshinë katër hapa kryesorë:

- i. Kushtet Minimale (KM-të) (shih kapitullin 3.1), të cilat shërbejnë si një bazë e vlerësimit e që duhet të përmbushen nga secila komunë partnere në mënyrë që të marrin një grant;
- ii. Matja e performancës së komunave duke u bazuar në një grup të treguesve (shih tabelën 1);
- iii. Ndarja e grantit (shih Shtojcën 1) për komunat bazuar në performancën e tyre, dhe
- iv. Monitorimi i zbatimit të projekteve përkatëse.

2.2. Objektivat prapa SGBP-së

SGBP-ja i adreson vetëm disa nga kompetencat vetanake të komunave (shih nenin 17 të Ligjit për vetëqeverisje lokale).

Qëllimi i SGBP-së është: a) përmirësimi i ofrimit të shërbimeve publike, demokracisë lokale, mbikëqyrjes së ekzekutivit dhe menaxhimit financiar; dhe b) nxitja e komunave për përdorimin dhe rritjen e të hyrave të tyre vetanake (THV), e cila do t'i bëjë komunat më autonome. Gjithashtu, SGBP-ja u ofron komunave partnere një mjet që mund të përdoret për të formuluar politikat dhe për t'i vendosur ato në linjë me objektivat zhvillimore afatgjate. Për më tepër, në njërin anë ai është një mjet i rëndësishëm për përmirësimin e lidhjeve në mes të qeverisjes lokale dhe qendrore dhe në anën tjetër për një angazhim më të madh të qeverisjes lokale dhe qytetarëve.

3. METODOLOGJIA E VLERËSIMIT

Vlerësimi i komunave sipas SGBP bëhet në baza vjetore, bazuar në të dhënat për vitin paraprak (p.sh. në vitin 2014 vlerësohet performanca e vitit 2013). Vlerësimi përfundimtar mbështetet në të dhënat zyrtare të institucioneve përkatëse të Kosovës (shih tabelën 2).

Hapat gjatë vlerësimit janë si në vijim:

1. Auditori i Përgjithshëm (AP) publikon raportin vjetor për secilën komunë.
2. Departamenti i Tatimit në Pronë (DTP), në kuadër të MF-së, publikon raportin(-et) vjetor për tatimin në pronë
3. MAPL-ja publikon raportin mbi performancën e komunave
4. Në mënyrë që të sigurojë vlefshmërinë e të dhënave, DEMOS-i angazhon një subjekt të jashtëm për të vlerësuar vlefshmërinë e të dhënave.
5. Prodhet raporti final mbi notimin e performancës dhe për grantet e ndara për secilën komunë sipas metodologjisë së DEMOS-it për peshim dhe notim.
6. Organizohet ceremonia shpërblyese me komunat.

3.1. Treguesit e performancës komunale

Komunat duhet të kalojnë nëpër kushtet minimale (KM-të) në vijim, të cilat përdoren edhe si kriteri i kualifikimit për t`iu qasur granteve:

- AP të mund të ofroj opinionin në raportin vjetor të auditimit;
- Shkalla minimale e inkasimit të tatimit në pronë të faturuar gjatë vitit është 30%;
- Të paguhet 100% tarifa e anëtarësimit në Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK);
- Të ndërmerren masat e nevojshme kundër korrupsionit në përputhje me Strategjinë e DEMOS-it kundër korrupsionit (shih kapitullin 7);
- Komunat të raportojnë të dhëna të sakta në SMP.
- Deri më 31 gusht të vitit aktual, komunat duhet të shpenzojnë mbi 90% të grantit që u është ndarë 2 vite më herët.¹

SGBP-ja ka 6 shkallë (nga 1 deri në 6). KM-të zbatohen për 4 shkallët e para të granteve (shih Shtojcën 1). Përveç kësaj, komunat të cilat radhiten në dy shkallët në krye (5 dhe 6; me notim 4.50 deri në 6), në mënyrë që të kualifikohen për mbështetjen e rezervuar buxhetore për sektorë, përveç që duhet të përmbushin të gjitha KM-të, e kanë edhe një kusht shtesë: inkasimin e 70% apo më shumë të tatimit në pronë të faturuar (duke përjashtuar borxhet) për vitin për të cilin do të vlerësohen.

¹ Për shembull, granti që është ndarë në shtator të vitit 2014, do të duhej të shpenzohej më së largu deri në fund të muajit gusht 2016. "Shpenzuar" nënkupton që "Faza 3" siç është shpjeguar në faqen 16, ka përfunduar në tërësi.

Pasi që të plotësohen të gjitha KM-të, performanca komunale matet përmes një grupi të treguesve (10) për fushat si vijojnë:

Tabela 1: Treguesit dhe fushat e punës

Fushat e punës	Treguesit	Synimet	Gama	Pesha
Menaxhimi financiar	% e rekomandimeve të raportit të vitit paraprak të auditorit të përgjithshëm të adresuara plotësisht	0-25%	0	1
		25-55%	1	
		55-80%	2	
		>80%	3	
	% e inkasimit të tatimit në pronë të faturuar gjatë vitit	0-30%	0	1.5
		30-50%	1	
		50-70%	2	
		>70%	3	
Hapësirat publike	Sipërfaqja e parqeve/shesheve për kokë banori, në metër katror (m ²)	0-1.5 m ² / kokë banori	0	0.42
		1.5-3 m ² kokë banori	1	
		3-4.5 m ² / kokë banori	2	
		>4.5 m ² / kokë banori	3	
	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total - në zonën urbane dhe rurale	0-25% e km	0	0.42
		25-50% e km	1	
		50-75% e km	2	
		>75% e km	3	
Mobiliteti	% e kilometrave të trotuareve të rregulluara	0-20 % e km	0	0.42
		20-40% e km	1	
		40-60% e km	2	
		>60% e km	3	
	% e rrugëve lokale në komunë që janë të asfaltuara	0-70%	0	0.42
		70-80%	1	
		80-90%	2	
		>90%	3	
Mbeturinat	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	0-60%	0	0.42
		60-75%	1	
		75-90%	2	
		>90%	3	
	% e pagesave të bëra	0-50%	0	0.42
		50-70%	1	
		70-90%	2	
		>90%	3	
Demokracia lokale	Numri i raportimeve të kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit komunal	0-1	0	0.5
		2-4	1	
		5-7	2	
		>8	3	
	% akteve të kuvendit komunal të publikuara	0-55%	0	0.5
		55-75%	1	
		75-95%	2	
		>95%	3	

Në konsultim me ZAP, DEMOS-i ka veçuar llogaritjen e treguesit të ndërlidhur me rekomandimet e auditorit. Llogaritja bën dallimin ndërmjet rekomandimeve me prioritetet të lartë dhe prioritet të mesëm (siç klasifikohen nga ZAP), duke i peshuar ato në 0.75 dhe përkatësisht 0.25. Objektivi i treguesit mbetet i njëjtë: matja e progresit në adresimin e rekomandimeve të viteve të kaluara. Pësha dhe synimet për këtë tregues janë paraqitur në tabelën më lartë.

3.2. Burimet e të dhënave

DEMOS-i do të shfrytëzojë vetëm informacionin zyrtar të publikuar nga institucionet e Kosovës, duke pranuar sistemet kombëtare statutores të informacionit dhe duke shmangur sistemet paralele të kushtueshme dhe të paqëndrueshme të mbledhjes së të dhënave.

Tabela 2: Burimet e të dhënave

	Treguesi	Burimi	
1	% e rekomandimeve të raportit të auditimit të përgjithshëm të vitit paraprak të adresuara plotësisht	Raportet e AP-së	ZAP
2	% e inkasimit të tatimit në pronë të faturuar gjatë vitit	Raportet e DTP-së	MF
3	Sipërfaqja e parqeve/shesheve për kokë banori, në metër katror (m ²)	Raporti mbi funksionimin e komunave në Republikën e Kosovës	MAPL
4	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total - në zonat rurale dhe urbane		
5	% e km të trotuareve të rregulluara		
6	% e rrugëve lokale në komunë që janë të asfaltuara		
7	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave		
8	% e pagesave të bëra për mbeturina		
9	Numri i raportimeve të kryetarit të komunës në mbledhjet e kuvendit komunal		
10	% akteve të kuvendit komunal të publikuara		

3.3. Peshimi dhe notimi i treguesve

SGBP-ja ka një sistem relativisht të thjeshtë të notimit që promovon efikasitetin dhe transparencën. Sistemi mund të evoluojë në bazë të mësimave të nxjerra përmes praktikës. Sistemi i notimit sipas peshës së caktuar për secilën fushë të punës të DEMOS-it dhe treguesit e tyre është prezantuar në tabelën e mëposhtme.

Sistemi i notimit varion nga 0 deri në 3 për secilin tregues. Rezultati 0 tregon se nuk është arritur cak minimal i vendosur për treguesin përkatës. Secili prej dhjetë (10) treguesve është i peshuar dhe notohet në përputhje me caqet e përcaktuara.

Tabela 3: Sistemi i peshimit dhe notimit të treguesve

Pesha	Fusha e punës	Treguesit	Synimet	Rezultati
1 nga 6 apo 17% e rezultatit të përgjithshëm	Auditimi i përgjithshëm	% e rekomandimeve të raportit të auditimit të përgjithshëm të vitit paraprak të adresuara plotësisht	0-25%	0
			25-55%	1
			55-80%	2
			>80%	3
1.5 nga 6 apo 25% e rezultatit të përgjithshëm	Tatimi në pronë	% e inkasimit të tatimit në pronë të faturuar gjatë vitit	0-30%	0
			30-50%	1
			50-70%	2
			>70%	3
0.42 nga 6 apo 7% e rezultatit të përgjithshëm	Hapësirat publike	Sipërfaqja e parqeve/shesheve për kokë banori, në metër katror (m ²)	0-1.5 m ² / kokë banori	0
			1.5-3 m ² / kokë banori	1
			3-4.5 m ² / kokë banori	2
			>4.5 m ² / kokë banori	3
0.42 nga 6 apo 7% e rezultatit të përgjithshëm		% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total - në zonën urbane dhe rurale	0-25% e km	0
			25-50% e km	1
			50-75% e km	2
			>75% e km	3
0.42 nga 6 apo 7% e rezultatit të përgjithshëm	Mobilitet	% e km të trotuareve të rregulluara	0-20 % e km	0
			20-40% e km	1
			40-60% e km	2
			>60% e km	3
0.42 nga 6 apo 7% e rezultatit të përgjithshëm		% e rrugëve lokale në komunë që janë të asfaltuara	0-70%	0
			70-80%	1
			80-90%	2
			>90%	
0.42 nga 6 apo 7% e rezultatit të përgjithshëm	Mbeturinat	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturave	0-60%	0
			60-75%	1
			75-90%	2
			>90%	3
0.42 nga 6 apo 7% e rezultatit të përgjithshëm		% e pagesave të bëra	0-50%	0
			50-70%	1
			70-90%	2
			>90%	3
0.5 nga 6 apo 8% e rezultatit të përgjithshëm	Demokracia lokale	Numri i raportimeve të kryetarit të komunës në mbledhjen e kuvendit komunal	0-1	0
			2-4	1
			5-7	2
			>8	3
0.5 nga 6 apo 8% e rezultatit të përgjithshëm		% akteve të kuvendit komunal të publikuara	0-55%	0
			55-75%	1
			75-95%	2
			>95%	3

Rezultati llogaritet mjaft thjeshtë; duke kombinuar dy faktorët (rezultatin dhe peshën) përmes një formule të thjeshtë:

$$X/(Y/Z)$$

ku:

X = pesha

Y=rezultati maksimal për treguesin përkatës; dhe

Z= rezultati aktual i komunës për treguesin përkatës.

Shembull: Pasi që gama e notimit përfshinë rezultatet prej 0, 1, 2 dhe 3, ku rezultati 3 është rezultati maksimal për tregues, le të themi se “% e rekomandimeve të raportit të auditimit të përgjithshëm të vitit paraprak të adresuara plotësisht” është notuar me 2, atëherë do të kemi:

X = 1 (pesha e këtij treguesi në rezultatin e përgjithshëm);

Y = 3 (rezultati maksimal për këtë tregues);dhe

Z = 2 (rezultati aktual i komunës për këtë tregues),

kështu, formula do të ishte $1/(3/2) = 1/1.5 = 0.67$. Prandaj, rezultati i asaj komune, për atë tregues, do të ishte 0.67. Në fund, rezultatet e secilit tregues do të mblidhen për të nxjerr rezultatin e përgjithshëm të komunës.

Rezultati i përgjithshëm maksimal të cilin një komunë mund të arrijë është 6. Secila komunë do të marrë një sasi të caktuar të granteve bazuar në notimin e përgjithshëm, duke e përdorur modelin e përshkruar më lartë. Tabela e detajuar me shumën e granteve të caktuara për notimin e ndryshëm është dhënë në Shtojcën 1.

DEMOS-i e bën notimin final për secilën komunë. Të dhënat zyrtare të ofruara nga institucionet përkatëse futen në sistemin e zhvilluar nga DEMOS-i. Rezultatet gjenerohen në mënyrë automatike. Para se të finalizohen, rezultatet diskutohen me institucionet e nivelit qendrorë dhe me komunat. Komunat kanë të drejtë të ankohen për rezultatet nëse dëshirojnë ta bëjnë këtë.

4. MEKANIZMI I ANKESËS

DEMOS-i harton fletënotimet çdo gusht dhe i ndanë ato me komunën e tij partnere, së bashku me shumën e grantit që do të jepet për vitin e ardhshëm. Nëse nuk janë pranuar ankesa, DEMOS-i konsideron se komuna partnere pajtohet me rezultatin e performancës. Megjithatë, nëse një komunë konsideron se rezultati nuk është sipas rregullave të këtij manuali, ajo ka të drejtë ankese.

DEMOS-i përdor qasjen ‘në sistem’, prandaj të dhënat e paraqitura në fletënotimet janë të dhënat zyrtare të publikuara nga institucionet e Kosovës. Në këtë drejtim, DEMOS-i është përgjegjës për shfrytëzimin e burimeve të duhura vjetore, kopjimin e saktë të të dhënave dhe llogaritjen e rezultateve, por nuk ka përgjegjësi për të dhënat dhe cilësinë e tyre. Nëse të dhënat origjinale janë duke u kontestuar, atëherë komuna duhet t’i drejtojë kërkesat e saj për sqarim tek institucioni përgjegjës që i ka publikuar të dhënat përkatëse. Nëse një komunë konteston burimin e drejtë, kopjimin e duhur të të dhënave ose llogaritjes apo zbulon gabime teknike në rezultatin që DEMOS-i ka dërguar, atëherë zbatohet mekanizmi i mëposhtëm i ankesës:

1.	DEMOS-i dërgon tek komuna rezultatin e tyre final të performancës	Deri më 17 gusht, para orës 17:00.
Ankesa në shkallën e parë		
2.	<p>Komuna ankohet tek DEMOS-i</p> <p>Ankesa në shkallën e parë duhet të justifikohet me të dhëna faktike.</p> <p>Ankesa është e pranueshme vetëm nëse vjen nga kryetari i komunës përkatëse.</p> <p>Ankesa duhet të dorëzohet me shkrim (letër) tek:</p> <p style="text-align: center;"><i>HELVETAS Swiss Intercooperation - Kosovë</i></p> <p style="text-align: center;"><i>kosovo.info@helvetas.org</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Tel: +381-(0)38-51.77.15</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Faks: +381-(0)38-51.88.33</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Nazim Gafurri 33, P.O. Box 2,</i></p> <p style="text-align: center;"><i>10000 Prishtinë, Kosovë</i></p> <p>Recepioni i HELVETAS do të ofrojë një fletë-kthesë me shkrim për ankesën.</p>	Deri më 23 gusht, para orës 17:00.
3.	<p>DEMOS-i thërret në takim ankuesin që të informohet më mirë mbi ankesën.</p> <p>DEMOS-i do të vendos dhe do të ofrojë përgjigje me shkrim në ankesë.</p>	Deri më 25 gusht, para orës 17:00.
Ankesa në shkallën e dytë		
4.	<p>Ankuesi mund të ushtrojë ankesë ndaj vendimit të shkallës së parë tek Zyra Zvicerane për Bashkëpunim – Kosovë.</p> <p>Ankesa në shkallën e dytë duhet të justifikohet me të dhëna faktike.</p> <p>Ankesa është e pranueshme vetëm nëse vjen nga kryetari i komunës përkatëse.</p> <p>Ankesa duhet të paraqitet me shkrim (letër) tek:</p> <p style="text-align: center;"><i>Zyra Zvicerane për Bashkëpunim SDC</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Rruga Rexhep Mala 6</i></p> <p style="text-align: center;"><i>10060 Prishtinë, Kosovë</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Tel. +381 38 248 091 / 092</i></p> <p style="text-align: center;"><i>Faks +381 38 248 096</i></p> <p style="text-align: center;"><i>pristina@eda.admin.ch</i></p> <p>Recepioni i ZZB do të ofrojë një fletë-kthesë me shkrim për pranimin e ankesës.</p>	Deri më 29 gusht, para orës 17:00.
5.	ZZB do të shqyrtojë ankesën dhe do të ofrojë me shkrim një vendim përfundimtar të justifikuar, për të dyja palët.	Deri më 31 gusht, para orës 17:00.

5. KALIBRIMI DHE PËRSHTATJA E GRANTEVE

Performanca komunale vlerësohet në baza vjetore, pas publikimit të dokumenteve zyrtare nga institucionet përkatëse. Për shembull, performanca komunale për vitin 2013 vlerësohet në vitin 2014 dhe pas shpalljes së rezultateve përfundimtare, granti do të disbursohet në fillim të vitit 2015; natyrisht, nëse komuna përkatëse ka përmbushur KM-të dhe ka arritur rezultatin minimal prej 0.50. Vlera e grantit u komunikohet komunave në muajin gusht/shtator në mënyrë që ata të mund t'i integrojnë fondet që do t'i pranojnë në buxhetet e tyre për vitin fiskal në vijim.

Viti i vlerësuar	Viti i vlerësimit, përshtatjes dhe zotimi	Viti i disbursimit
2013	2014	2015

Komunat kualifikohen për grante pasi që të arrijnë rezultatin prej së paku 0.5. Komunat me rezultatin më të vogël se ky, d.m.th. 0 deri në 0.49, nuk kualifikohen për grante nga DEMOS-i. Granti bazik llogaritet në bazë të popullsisë së komunës, sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të popullsisë. Megjithatë, faktori i barazimit mundëson që komunat e vogla të marrin më shumë fonde për kokë banori, krahasuar me komunat më të mëdha.

Kur rezultati për një komunë të caktuar është në mes të 0.5 dhe 1.49, ajo komunë do të marrë grantin bazik. Variacionet tjera janë të përshkruara në mënyrë progresive në tabelën më poshtë. Shuma e granteve për secilin rezultat dhe për secilën komunë është përshkruar në Shtojcën 1.

Tabela 4: Përmbledhje e progresionit dhe kalibrimit të grantit

Fillimi	Progresioni				Kulmi	
	base grant	+10%	+20%	+30%	+60%	+90%
0 – 0.49	0.50-1.49	1.50-2.49	2.50-3.49	3.50-4.49	4.50-5.49	5.50-6.00
Kushtet minimale	Matja e performancës	Shërbimet publike (hapësirë publike, mobiliteti dhe mbeturinat)		Kushtet minimale + Matja e performancës + mbledhja e 70% ose më shumë e tatimit në pronë të faturuar		
		Demokracia lokale				
		Menaxhimi financiar				
NUK KA PROJEKTE	PROJEKTI				MBËSHTETJA E REZERVUAR BUXHETORE PËR SEKTORË (NUK NEVOJITET PROJEKT-PROPOZIMI)	
Asistenca teknike E nxitur nga DEMOS-i	Asistenca teknike E paracaktuar, në 5 fusha: hapësira publike, mobiliteti, mbeturinat, menaxhimi financiar dhe demokracia lokale Sipas kërkesës, në 5 fusha: hapësira publike, mobiliteti, mbeturinat, menaxhimi financiar dhe demokracia lokale				Asistenca teknike E kufizuar sipas kërkesës në 5 fusha: hapësira publike, mobiliteti, mbeturinat, menaxhimi financiar dhe demokracia lokale	

Megjithatë, nëse performanca komunale bie, që nënkupton se rezultati është më i ulët se në vitin paraprak, vlera e grantit poashtu zvogëlohet.

5.1. Llojet e grantit dhe modalitetet

Tabela më poshtë shpjegon në detaje llojet e granteve dhe përdorimin e tyre duke u bazuar në notimin e përgjithshëm, nivelin e bashkëfinancimit nga komunat, metodat e disbursimit dhe raportimit. Nëse komunat arrijnë rezultatin nga 0 deri në 0.49 atëherë ato nuk do të pranojnë grant. Ato do të kenë të drejtën e marrjes së AT-së në 5 fushat e punës së DEMOS-it. Nëse komunat arrijnë çfarëdo rezultati në mes të 0.50 deri në 4.49, ato do të pranojnë grantin sipas rezultatit të tyre të saktë; megjithatë fleksibiliteti në përdorimin e granteve nga ana e komunave është i kufizuar. Komunat do të duhet të dorëzojnë projekt-propozimet relevante për 5 fushat ndërsa DEMOS-i vendos se cilat kualifikohen për mbështetje. Për më tepër, DEMOS-i rezervon të drejtën që të marrë pjesë në tenderim, monitorimin teknik dhe auditimin e projekteve të financuara nga granti.

Nëse komunat arrijnë rezultatin 4.50 apo më të lartë, atëherë ekziston një rritje e konsiderueshme në shumën e grantit që do t'u ndahet komunave (për më shumë detaje shih Shtojcën 1) dhe në fleksibilitetin e përdorimit të granteve. Për më shumë detaje, shih tabelën më poshtë:

Tabela 5: Llojet dhe modalitetet e granteve

Përshkrimi	Financimi i projektit në fushat e përzgjedhura	Mbështetja e rezervuar buxhetore për sektorë
Pragu për qasje në grante	Rezultati nga 0.50 deri në 4.49	Rezultati nga 4.50 deri në 6
Bashkëfinancimi	30% (për vitin e parë)	Nuk kërkohet bashkëfinancimi
Shpenzimet e pranueshme	Projekt-propozimet kapitale të ndërlidhura me shërbimet prioritare komunale, demokraci lokale apo menaxhim financiar. Shpenzimet relevante për propozimin janë të pranueshme, përveç personelit. Propozimi duhet të hartohet dhe dorëzohet sipas modeleve të zhvilluara paraprakisht nga DEMOS-i.	Të gjitha shpenzimet për cilëndo nga 5 fushat janë të lejuara, përveç personelit. Projekt-propozimi nuk është i nevojshëm.
Asistenca teknike (AT)	DEMOS-i përcakton përmbajtjen e AT-së nëse rezultati është 0. Për rezultatet nga 0.50 deri në 4.49, AT-ja bazohet në kërkesën komunale apo në marrëveshje me DEMOS-in.	Me rezultatin prej 4.50 apo më të lartë, AT është e kufizuar sipas kërkesës.
Monitorimi nga DEMOS-i	I lartë deri në mesatar	I ulët
Disbursimi	Dy këste: 70% pasi që kontrata me komunën të jetë nënshkruar, pjesa tjetër e mbetur prej 30%, pas përfundimit të punës.	Dy këste: 90% në fillim të vitit dhe pjesa tjetër prej 10% pasi të jetë gjeneruar raporti i auditimit komunal (viti i ardhshëm, muaji maj)
Raportimi	Pranimi teknik, raporti narrativ dhe raporti financiar, auditimi i raportit financiar	Raporti i rregullt i AP, auditimi i DEMOS-it nëse dhe kur të shihet si i nevojshëm

Përveç granteve bazike, komunat partnere mund të pranojnë shpërblime shtesë, për kategoritë e mëposhtme:

1. **Performuesi më i mirë** – Performuesit më të mirë janë komunat që kanë notën më të lartë për vitin e caktuar
2. **Përmirësuesi më i mirë** – Përmirësuesit më të mirë janë komuna nota e të cilave është ngritur më së shumti në vitin e caktuar
3. **Përmirësuesit më të mirë në mirë në menaxhim financiar** – Përmirësuesit më të mirë janë komunat rezultati i të cilave është përmirësuar më së shumti për 2 treguesit që masin menaxhimin financiar, në vitin e caktuar
4. **Përmirësuesit më të mirë në shërbimet publike** – Përmirësuesit më të mirë janë komunat rezultati i të cilave është përmirësuar më së shumti për 6 treguesit që masin shërbimet publike, në vitin e caktuar
5. **Përmirësuesit më të mirë në demokraci lokale** – Përmirësuesit më të mirë janë komunat rezultati i të cilave është përmirësuar më së shumti për 2 treguesit që masin demokracinë lokal, në vitin e caktuar.

Për tu kualifikuar për shpërblim në cilëndo prej kategorive të mësipërme, raporti i auditimit të komunës për vitin vlerësues duhet të ketë jo më pak se opinion të pakualifikuar.

Çdo kategori i ka 3 shpërblime, përveç nëse janë 2 çifte komunash me rezultat të njejtë, gjë që rezulton në ndarjen e 4 shpërblimeve (2 x vendi i 1-rë dhe 2 x vendi i 2-të).

Nëse për cilëndo nga kategoritë e mësipërme, nuk ka përmirësim për vitin vlerësues në mesin e komunave partnere, atëherë nuk do të ndahen shpërblime për atë kategori, në atë vit. Vetëm përmirësimi shpërblehet.

5.1.1. Performuesit më të mirë

DEMOS-i vlerëson rezultatet e secilës komunë në krahasim me të gjitha të tjerat dhe identifikon tri komunat që kanë arritur rezultatin më të lartë në një vit. Këto komuna do të pranojnë një grant shtesë (përveç grantit të rregullt). Komuna që ka rezultatin më të mirë pranon një shtesë prej 100% të grantit që do të jepet atë vit, rezultati i dytë më i mirë pranon një shtesë prej 90% dhe rezultati i tretë më i mirë pranon një shtesë prej 80%.

Ky grant shtesë do të konsiderohet si pjesë e grantit të rregullt dhe ky manual vlen edhe për atë pjesë.

5.1.2. Përmirësuesit më të mirë

5.1.2.1. Përmirësuesi më i mirë i përgjithshëm

Ngjashëm me performuesit më të mirë, DEMOS-i vlerëson rezultatet e secilës komunës në krahasim me rezultatin e tyre vetanak nga viti paraprak dhe identifikon tri komunitat që kanë arritur përmirësimin më të madh të rezultatit të tyre (rezultati i përgjithshëm i vitit aktual i krahasuar me rezultatin e përgjithshëm të vitin paraprak). Këto komuna do të pranojnë një grant shtesë (përveç grantit të tyre të rregullt). Përmirësuesi më i mirë pranon një shtesë prej 100 % të grantit që të do të jepet gjatë atij viti, përmirësuesi i dytë më i mirë pranon një shtesë prej 90% dhe përfituesi i tretë më i mirë pranon një shtesë prej 80%.

Ky vlerësim bazohet në të gjithë 10 treguesit.

Ky grant shtesë do të konsiderohet si pjesë e grantit të rregullt dhe ky manual aplikohet edhe për atë pjesë.

5.1.2.2. Përmirësuesi më i mirë në menaxhim financiar

DEMOS-i vlerëson rezultatet e secilës komunës në krahasim me rezultatin e tyre vetanak nga viti paraprak dhe identifikon tri komunitat që kanë arritur përmirësimin më të madh të rezultatit të tyre treguesit e menaxhimit financiar (rezultati në vitin aktual i krahasuar me rezultatin në vitin paraprak). Këto komuna do të pranojnë një grant shtesë (përveç grantit të tyre të rregullt). Përmirësuesi më i mirë pranon një shtesë prej 100 % të grantit që të do të jepet gjatë atij viti, përmirësuesi i dytë më i mirë pranon një shtesë prej 90% dhe përfituesi i tretë më i mirë pranon një shtesë prej 80%.

Ky vlerësim bazohet në 2 tregues:

1. % e rekomandimeve të raportit të vitit paraprak të auditorit të përgjithshëm të adresuara plotësisht % e inkasimit të tatimit në pronë të faturuar gjatë vitit
2. Ky grant shtesë do të konsiderohet si pjesë e grantit të rregullt dhe ky manual aplikohet edhe për atë pjesë.

Ky grant shtesë do të konsiderohet si pjesë e grantit të rregullt dhe ky manual aplikohet edhe për atë pjesë.

5.1.2.3. Përmirësuesi më i mirë në shërbime publike

DEMOS-i vlerëson rezultatet e secilës komunës në krahasim me rezultatin e tyre vetanak nga viti paraprak dhe identifikon tri komunitat që kanë arritur përmirësimin më të madh të rezultatit të tyre treguesit e shërbimeve publike (rezultati në vitin aktual i krahasuar me rezultatin në vitin paraprak). Këto komuna do të pranojnë një grant shtesë (përveç grantit të tyre të rregullt). Përmirësuesi më i mirë pranon një shtesë prej 100 % të grantit që të do të jepet gjatë atij viti, përmirësuesi i dytë më i mirë pranon një shtesë prej 90% dhe përfituesi i tretë më i mirë pranon një shtesë prej 80%.

Kjo analizë bazohet në 6 tregues:

1. Sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë banori, në metër katror (m²)
2. % e km rrugë me ndriçim publik – nga numri i përgjithshëm - në zonat urbane dhe rurale
3. % e km të trotuareve të rregulluara
4. % e rrugëve lokale në komunë, që janë të asfaltuara
5. % e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave
6. % e pagesave të bëra

Ky grant shtesë do të konsiderohet si pjesë e grantit të rregullt dhe ky manual aplikohet edhe për atë pjesë.

5.1.2.4. Përmirësuesi më i mirë në demokraci lokale

DEMOS-i vlerësonë rezultatet e secilës komunës në krahasim me rezultatin e tyre vetanak nga viti paraprak dhe identifikon tri komunat që kanë arritur përmirësimin më të madh të rezultatit të tyre treguesit e demokracisë lokale (rezultati në vitin aktual i krahasuar me rezultatin në vitin paraprak). Këto komuna do të pranojnë një grant shtesë (përveç grantit të tyre të rregullt). Përmirësuesi më i mirë pranon një shtesë prej 100 % të grantit që të do të jepet gjatë atij viti, përmirësuesi i dytë më i mirë pranon një shtesë prej 90% dhe përfituesi i tretë më i mirë pranon një shtesë prej 80%.

Kjo analize bazohet në 2 tregues:

1. Numri i raportimeve të kryetarit të komunës në takimet e kuvendit komunal
2. % akteve të publikuara të kuvendit komunal

Këto grante shtese do të konsiderohen si pjesë e grantit të rregullt dhe ky manual vlen edhe për atë pjesë.

6. ADMINISTRIMI I GRANTEVE²

Zbatimi i grantit fillon brenda javëve pas publikimit të rezultateve përfundimtare dhe granteve. Numri i aktiviteteve është i konsiderueshëm.

Ato grupohen në tri faza:

- a. Procesi identifikimit, hartimit të projekteve fillestare të propozuara, si dhe sigurimi i pajtueshmërisë së tyre me rregullat e prezantuara në këtë manual, etj.
- b. Përfundimi i hartimit të projekteve, duke përfshirë të gjitha detajet relevante për secilin projekt individual, procedurat e tenderimit, aranzhimet kontraktuale dhe të bashkëfinancimit etj.; dhe
- c. Procesi i zbatimit dhe finalizimit, duke përfshirë mjetet e raportimit dhe monitorimit.

² Të gjitha grantet administrohen nga komuna. DEMOS-i ofron vetëm asistencë teknike. Përjashtimet mund të bëhen sipas strategjisë kundër korrupsionit, kapitulli 7, faqe 16.

DEMOS-i ndërmerr të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar përdorimin e duhur dhe të saktë të granteve. Tabela e mëposhtme përshkruan në detaje aktivitetet për secilën fazë.

Tabela 6: Procedurat administrative të grantit

Aktivitet	Përshkrimi i detajuar
Faza 1	
Dërgohet ftesë në komunë për dorëzimin e projekt-propozimeve, duke përfshirë dëshminë dokumentuese mbi kriteret e kualifikueshmërisë bazuar në natyrën e projektit të propozuar	<p>Kriteri i kualifikueshmërisë përfshinë dëshminë në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • aplikacionin e projektit • dëshmia se projekti është i përfshirë në listën e investimeve kapitale të komunës apo dëshmia se projekti është aprovuar nga Kuvendi Komunal • dëshmia se kontributi i ndarë prej minimumit 30% ndahet nga komuna • dëshmia se lokacioni për zbatimin e projektit është pronë publike komunale (kopja e planit, certifikata e pronësisë, ortofoto)
Personeli i DEMOS-it vlerëson kriteret e kualifikueshmërisë dhe informon komunitat.	
<p>DEMOS-i ofron ekspertizë përmes asistencës teknike në fushën e ndërlidhur për të ndihmuar komunën gjatë fazës së dizajnit. Kjo asistencë është kryesisht në lidhje me kontrollin e cilësisë dhe asistencën – nëse është e nevojshme – në procesin e dizajneve të prodhuara nga komunitat.</p> <p>Ekspertët e DEMOS-it konfirmojnë përfundimin e dizajnit të projektit.</p>	
Faza 2	
Dizajni i projektit përgatitet nga komuna dhe konfirmohet nga ekspertët	<p>Përfshinë dokumentet në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrimi teknik i projektit, • Dizajni i projektit, • Paramasa dhe paralogaria (PP) (në rast të punimeve) • Orari i zbatimit
DEMOS-i dhe komuna nënshkruajnë kontratën	Kontrata përcakton termet dhe kushtet për disbursimin e grantit, bazuar në projektin e propozuar për zbatim, duke përfshirë përgjegjësitë e bashkëfinancimit. Kjo siguron se granti është destinuar sipas rregullave të përcaktuara në këtë manual dhe nuk ka mundësi për tejkalimin e vlerës, ndërsa komunitat lejohehen për shtimin e burimeve financiare nëse dëshirojnë.
DEMOS-i punëson auditor të jashtëm për t'i ndihmuar komunat në përgatitjen e procesit të prokurimit (përgatitjen e dosjes së tenderit).	Komunitat janë bartëse të procesit të prokurimit, sipas ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës, ndërsa DEMOS-i mbështet të gjitha fazat e ciklit të zbatimit të projektit (përgatitja, procesi i tenderimit, zbatimi dhe zbatimi më pas).
Komuna transferon shumën e saj të bashkëfinancimit	
DEMOS-i transferon këstin e tij të parë prej 70%	Komuna është e gatshme të fillojë zbatimin. Prandaj, komuna emëron organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kontraktuesit gjatë procesit të zbatimit. DEMOS-i angazhon ekspertë teknik dhe auditorin e jashtëm për mbështetjen e procesit të monitorimit të zbatimit të projektit.

Faza 3

Komisioni komunal do ta konfirmojë përfundimin e punimeve/shërbimeve	Në bashkëpunim të ngushtë me DEMOS-in, ekspertët dhe auditori, në mënyrë që të konfirmojë se projekti është përfunduar në përputhje me dizajnin origjinal të projektit.
Ekspertët teknik të DEMOS-it angazhohen me komunën për të përfunduar procesin e dokumentimit, si dhe vlerësuar të gjithë projektin.	<p>DEMOS-i kërkon dokumentet në vijim para se të transferohet kësti i fundit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Formulari i dorëzimit • Raporti i ekspertit teknik mbi përfundimin • Raporti i auditimit mbi përfundimin • Ditari i vendit • Libri i ndërtimit • Raporti narrativ • Raporti financiar • Raporti i nënshkruar i pranimit teknik (raporti komunal) • Pasqyrat financiare (pjesa e DEMOS-it dhe ajo komunale – bashkëfinancimi)
Duke pasur parasysh se janë përmbushur kushtet e përmendura më lartë, DEMOS-i transferon këstin e dytë (30%)	

7. MASAT KUNDËR KORRUPSIONIT PËR KOMUNAT PARTNERE TË DEMOS-IT

DEMOS-i kërkon përdorimin e masave kundër korrupsionit për krijimin e një situatë që është e drejtë për të gjitha komunat partnere. Masat kundër korrupsionit bazohen në ‘rastet e padisë’. Arsyet për këtë janë si në vijim:

1. Vendimet përfundimtare nuk janë të përshtatshme sepse janë individuale dhe nuk do të ishte adekuat “dënimi” i tërë komunës nëse një anëtar i personelit ka vendosur të përfshihet në aktivitete të paligjshme. Për më tepër, vendimi për një vendim përfundimtar zakonisht merr shumë kohë, gjë që nuk do të kishte rëndësi në kuadër të periudhës së projektit të DEMOS-it.
2. Rastet nën hetime, para lëshimit të padisë, janë konfidenciale dhe shumë të ndjeshme. Do të ishte e papërshtatshme për DEMOS-in që të ndërlihdë disbursimin e grantit me këto procese.
3. Parimi ligjor ‘personi është i pafajshëm deri sa të dëshmohet fajësia’ nuk do ta lejonte DEMOS-in të bazonte suspendimin mbi një rast nën hetim (para padisë).
4. Përjashtimi i komunave bazuar në hetim (para padisë) do të hapte mundësinë për abuzim (personat e tretë që paraqesin raste për arsye politike).

Masat kundër korrupsionit të DEMOS-it janë si në vijim:

1. **Rasti:** Nëse është paditur kryetari i komunës partnere ose drejtorët e emëruar politikisht.

Masa: DEMOS-i nuk do t'i transferojë fondet në llogarinë e komunës dhe t'i menaxhojë ato plotësisht, duke përfshirë dizajnimin/planifikimin, tenderimin, vlerësimin dhe monitorimin e projekteve deri në përfundimin e procesit. Pas përfundimit të procesit gjyqësor dhe ri-përcaktimit të parakushteve, DEMOS-i mund t'ia lejojë përsëri komunës pranimin e fondeve.

2. **Rasti:** Nëse shërbyesit civil janë të paditur.

Masa: DEMOS-i kërkon nga kryetari i komunës ndërmerr masa të menjëhershme kundër personelit nën hetime sipas Nenit 69 të Ligjit mbi Shërbimin Civil. DEMOS-i do të kërkojë prova që komuna ka ndërmarrë veprime e domosdoshme disiplinore (letrën e suspendimit). Nëse një komunë nuk e suspendon personelin e saj të paditur, atëherë DEMOS nuk do të transferojë mjete në llogarinë e komunës por do të marrë përsipër menaxhimin financiar të mjeteve. Dizajnimi, planifikimi, tenderimi, vlerësimi dhe monitorimi i projekteve deri në përfundim të procesit, do të vazhdojë të bëhet në bashkëpunim me komunën.

Masat e përmendura më lartë do të jenë të zbatueshme përgjatë fazës së projektit.

Shtojca 1: Ndarja e granteve sipas komunave bazuar në rezultate

Rezultati		0.5-1.49	1.5-2.49	2.5-3.49	3.5-4.49	4.5-5.49	5.5-6.0
Komuna							
1	Prishtinë/Priština	240,000	264,000	288,000	312,000	384,000	456,000
2	Gjakovë/Đakovica	100,000	110,000	120,000	130,000	160,000	190,000
3	Pejë/Peç	100,000	110,000	120,000	130,000	160,000	190,000
4	Viti/Vitina	45,000	49,500	54,000	58,500	72,000	85,500
5	Rahovec/Rahovec	45,000	49,500	54,000	58,500	72,000	85,500
6	Lipjan/Ljipjan	45,000	49,500	54,000	58,500	72,000	85,500
7	Kamenicë/Kamenica	40,000	44,000	48,000	52,000	64,000	76,000
8	Kaçanik/Kaçanik	40,000	44,000	48,000	52,000	64,000	76,000
9	Shtime/Štimlje	40,000	44,000	48,000	52,000	64,000	76,000
10	Novobrdë/Novobërd	30,000	33,000	36,000	39,000	48,000	57,000
11	Štrpce/Shtërpc	30,000	33,000	36,000	39,000	48,000	57,000
12	Hani i Elezit/Hani I Elezit	30,000	33,000	36,000	39,000	48,000	57,000
13	Junik/Junik	30,000	33,000	36,000	39,000	48,000	57,000
14	Gračanica/Gračanicë	30,000	33,000	36,000	39,000	48,000	57,000
15	Parteš/Partesh	20,000	22,000	24,000	26,000	32,000	38,000
16	Klokot/Kllokot	20,000	22,000	24,000	26,000	32,000	38,000
17	Ranilug/Ranillug	20,000	22,000	24,000	26,000	32,000	38,000



NEWBORN

Nazim Gafurri str.33
PO Box no.2
1000 Pristina, Kosovo
www.helvetas-ks.org

Tel: +381(0)38 51 77 15
Tel: +381(0)38 51 66 44
Fax: +381(0)38 51 88 33
kosovo.info@helvetas.org